



SPRÅK  
KEDJAN

# VALIXHE TË MBUSHURA ME DËSHIRA GJUHE!

Projekti Valixhet e zinxhirit të gjuhës, është nxjerrë në dritë, që ti si prind të kesh këshilla se si ti dhe fëmija yt mund të luani dhe të punoni me gjuhën. Valixhet, posaçërisht, përshtaten mirë të përdoren, nëse fëmija yt ka vështirësi me zhvillimin e gjuhës së tij dhe nëse ju keni kontakt me një logoped.

Çdo valixhe përmban lojëra, material lojërash, libra, dhe këshilla për lojëra, ku nuk ka nevojë të kesh ndonjë material shtesë. Një pjesë e valixheve përmbajnë edhe CD me këngë dhe përralla të incizuara dhe një DVD, ku mund të shohësh udhëzime, se si përdoret materiali i valixhes.

Valixhet janë në ndonjërin nga bibliotekat në komunën tënde. Kontakto personelin, se ata të ndihmojnë me porositjen e asaj valixhe, të cilën dëshiron të huazosh.

Janë gjashtë valixhe të ndryshme dhe këtu pranë mund të lexosh, se çfarë drejtimi ka secila valixhe. Nëse je i/e pasigurt se cila valixhe i përshtatet fëmijës tënd, atëherë fol për këtë me logopedin e fëmijës, pedagogun e parashkollës, infermieren e Qendrës shëndetësore për fëmijë, ose me bibliotekarin tënd për fëmijë.

Merri me dëshirë me vete lojërat dhe i përdorë ato në jetën tuaj të përditshme, jashtë në këndin e lojërave, ose ndoshta një çast në makinë. Më e rëndësishme nga të gjithat është, që ti dhe fëmija yt të argëtoheni së bashku, kur ju e përdorni materialin!

Nëse dëshiron të dish më shumë, mund të hyjsh në [www.regionhalland.se/sprakkedjan](http://www.regionhalland.se/sprakkedjan)



### **ALFONS-TRASTA: stimulon për harmonizim të gjuhës**

Lojërat dhe materiali në këtë valixhe japin këshilla, se si ti dhe fëmija yt mund të punoni me shprehjen e ndjenjave, imitohj njëri tjetrit dhe të flisni për situatat e ndryshme që mund të hasësh. Ju punoni duke e pritur radhën tënde, në lojë dhe lojëra.



### **SORRA-TRASTA DHE MERIMANGA-TRASTA: e ndihmon fëmijën të ketë një fjalor të pasur dhe të ndryshëm**

Me materialet në këto valixhe, ti luan me fëmijën tënd, me fjalë dhe me domethënien e fjalëve. Në një mënyrë, me plotë dëshirë, ju ushtroni të mësoni shumë fjalë, domethënien e tyre dhe si lidhen ato në mes veti. Për të kuptuar se çka rrëfejnë të tjerët ose për t' u kuptuar kur ti përshkruan ose rrëfen diçka, kërkohet një fjalor i pasur dhe i ndryshëm. Materiali në Merimangë-trastën dëshiron të zgjojë dëshirën, të klasifikoj fjalë, të ndajë ato në grupe fjalësh, të imagjinoj e të lidhë ato. Me materialin në Sorra trastën, në mes tjerash, luan me të gjitha ato fjalët e shkurtra të një bisede, për shembull si, mbi, brenda, sipër si dhe të kundërtën.





### **EMIL-TRASTA:**

**ushtron zërin e gjuhës, të dëgjosh dhe të gjesh ato saktë në gojë**

Me përmbajtjen e kësaj valixhe, së bashku, ti dhe fëmija yt, ushtroni të dëgjoni zëra, të luani me zëra të ndryshëm të gjuhës dhe të bëni lëvizje të ndryshme me gojë. Kjo është mirë të dini, nëse do të ushtroni te logopedi ose në shtëpi të gjitha ato zërat e nevojshëm që e folmja të bëhet e qartë.

### **PIPPI-TRASTA EDHE BU DHE BE-TRASTA:**

**ushtron gramatikën dhe renditjen e fjalëve**

Me materialet në këto valixhe luani së bashku, ti dhe fëmija yt, me përralla dhe tregime. Fëmija ushtron që të rrëfej sërish përrallat, të këndoje këngë, dhe të mbaj mend se çfarë ke rrëfyer ose lexuar. Përmbajtja e valixheve ndihmon të forcoj aftësinë e fëmijës, që vet të rrëfej dhe të përshkruaj, të krijoj fjali të gjata dhe të lakoj fjalë në mënyra të ndryshme.







Projekti **Zinxhri i gjuhës është, një zinxhir i pakëputur për të folmen dhe zhvillimin e gjuhës**, është një projekt bashkëpunimi në mes Ekipit të kujdesit shëndetësor për fëmijë dhe Kulturës në Halland – bibliotekës së rajonit. Metodat dhe materiali në valixhet e gjuhës janë zhvilluar nga një grup referimi, i cili përbëhet nga një logoped, një pedagog parashkolle, tre bibliotekarë dhe një infermiere nga Qendra shëndetësore për fëmijë në Halland, së bashku me udhëheqësinë e projektit. Pronar i projektit është Kultura në Halland – biblioteka e rajonit dhe udhëheqës të projektit janë Maria Ehde Andersson dhe Gerd Almqvist Tangen. Projekti ka marrë mbështetje ekonomike nga Këshilli i kulturës dhe Rajoni Halland.



**KULTURRÅDET**



**Region Halland**  
Kultur i Halland

Box 517, SE-301 80 Halmstad  
regionen@regionhalland.se • www.regionhalland.se